

Deklaratë për shtyp

Mos të shpërndahet deri në orën 09:00 CEST me orën e Parisit, të 14 shtatorit, 2022

Rritja e ndjeshme në burimet e rinovueshme në Evropën Juglindore dhe Lindore, Kaukaz dhe Azinë Qendrore, duhet të përshpejtohet për t'i dhënë fund varësisë nga burimet fosile dhe për të rritur sigurinë energjitike

- Burimet e rinovueshme dhe efikasiteti i energjisë ofrojnë një mundësi për një furnizim të sigurt dhe sovran me energji në rajon. Këto janë gjetje të REN21 dhe Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) në raportin e tyre të fundit të statusit rajonal.
- Rajoni ka shënuar një rritje të paprecedent të energjisë elektrike të rinovueshme që nga viti 2018. Sektorët e transportit dhe ngrohje-ftohjes nuk kanë shënuar rritje të tilla.
- Investimet publike dhe private në burimet e rinovueshme në vendet në fokus, mbeten modeste në krahasim me prirjet në rritje botërore. Vendet e rajonit kanë nevojë për investime të konsiderueshme në burimet e rinovueshme.
- Pushtimi rus preku 90% të kapacitetit të energjisë së erës të Ukrainës dhe 30% të kapacitetit të saj të energjisë diellore, që përfaqëson rreth një të katërtën e kapacitetit total të erës dhe një të pestën e kapacitetit diellor në rajon.

Paris, 14.09.2022 – Mes 2017¹ dhe 2021, në 17 shtete të Evropës Juglindore dhe Lindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore, plus Kosovën², u pa një rritje e paprecedent në kapacitetin e energjisë së rinovueshme. Gjatë kësaj periudhe, këto shtete shtuan në mënyrë kumulative 21 gigavat (GV) kapacitet, për një kapacitet total të instaluar të energjisë së rinovueshme prej 106 GV³. Për herë të parë, kjo rritje u nxit kryesisht nga shtesat e fotovoltaikeve diellorë (PV) (58%) dhe të energjisë së erës (25%). Mes viteve 2017 dhe 2021, kapaciteti i energjisë së erës në rajon u rrit me më shumë se një faktor 7te dhe kapaciteti diellor FV me më shumë se një faktor 10te.

Gjatë kësaj periudhe, Ukraina instaloi kapacitetin më të madh të energjisë diellore FV dhe të erës (8.3 GV), e ndjekur nga Kazakistani (3.7 GV) dhe Federata Ruse (3.5 GV). Këto tre vende u renditën të gjitha në mesin e 30 vendeve më të mira në botë për investime në energjinë e rinovueshme në vitin 2019, me Ukrainën në vendin e 17-të (3.4 miliardë dollarë), Federatën Ruse në vendin e 20-të (2.3 miliardë dollarë) dhe Kazakistanin në vendin e 28-të (0.8 miliardë dollarë).

I publikuar sot, *Raporti i Statusit të Energjisë së Rinovueshme të UNECE 2022*, u përgatit bashkërisht nga Rrjeti i Politikave të Energjisë së Rinovueshme për Shekullin 21 (REN21) dhe Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE). Ai ofron përditësimin më të fundit mbi statusin e burimeve të rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë në Shqipëri, Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi,

¹ Botimi i mëparshëm i *Raportit mbi Statusin e Energjisë së Rinovueshme UNECE (Renewable Energy Status Report UNECE)* të REN21, u botua në 2017 dhe është i disponueshëm këtu: <https://www.ren21.net/2017-unece-renewable-energy-status-report>.

² Të gjitha referencave ndaj Kosovës, janë bërë në kontekstin e Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

³ Për krahasim, kapaciteti botëror i instaluar i energjisë së rinovueshme, arriti në 3,146 GW më 2021 (REN21 2022).

Bosnje dhe Hercegovinë, Gjeorgji, Kazakistan, Kosovë, Republikën Kirgistan, Moldavi, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Federatën Ruse, Serbi, Taxhikistan, Turkmenistani, Ukrainë dhe Uzbekistan.

Siguria energjetike në plan të parë

Pavarësisht përparimit të madh në burimet e rinovueshme, këto vende në focus, vazhdojnë të varen shumë nga burimet e karburanteve fosile, si dhe mbështeten në një numër të kufizuar eksportuesish të energjisë, veçanërisht në Federatën Ruse. Sipas raportit, 13 nga vendet në fjalë, janë shumë të varura nga importet e energjisë, ndërkohë që 4 vende (Armenia, Bjellorusia, Gjeorgjia dhe Moldavia) importojnë më shumë se 70% të totalit të tyre të furnizimit me energji parësore. Burimet e rinovueshme mund t'i ndihmojnë shtetet të diversifikojnë furnizimin e tyre me energji, si dhe të mbrohen nga luhatjet e mëdha të çmimeve të gazit natyror dhe naftës.

Subvencionet e mëdha për lëndët djegëse fosile dhe tarifatat artificialisht të ulëta për energjinë me bazë fosile dhe atë bërthamore, pengojnë aplikimin e shpejtë të burimeve të rinovueshme në të gjithë sektorët. Megjithëse madhësia e subvencioneve të energjisë si pjesë e produktit të brendshëm bruto (PBB) ka rënë në të gjitha vendet në focus, ajo kishte ende një peshë të rëndësishme në vitin 2020, veçanërisht në Uzbekistan (6.6%), Turkmenistan (3.2%), Kazakistan (2.6%) dhe Azerbajxhan (2.4%).

“Rritja e energjisë së rinovueshme në rajon deri në vitin 2021, u nxit kryesisht nga politikat e favorshme dhe nga rënia e kostove të teknologjive të energjisë së rinovueshme, por tani, siguria e energjisë është absolutisht në plan të parë. Largimi nga karburantet fosile nuk ka qenë kurrë kaq jetike për rajonin”, tha Rana Adib, Drejtore Ekzekutive e REN21.

“Me bisedimet e OKB-së për klimën (COP27) vetëm disa muaj larg, vendet dhe investitorët në rajonin e UNECE duhet urgjentisht të dyfishojnë sërish angazhimet e tyre për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme për të arritur objektivat botërore të zero emetimeve neto, dhe për t'i dhënë fund varësisë nga karburantet fosile”, tha Sekretarja Ekzekutive e UNECE, Olga Algayerova. *“Ky veprim është gjithashtu jetik në ndihmesën ndaj shteteve që të shkojnë në rrugën e duhur për të përmbushur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe për të përshpejtuar kalimin drejt sistemeve ripërtëritëse të energjisë. Rritja e investimeve në burimet e rinovueshme është thelbësore për forcimin e sigurisë energjetike dhe përballueshmërinë e kostove të saj në dritën e tronditjeve energjetike dhe financiare që lidhen me konfliktin në Ukrainë”.*

Pushtimi rus i Ukrainës minon përparimin në energjitë e rinovueshme në rajon

Si pasojë e pushtimit prej Federatës Ruse, rreth 90% e kapacitetit të instaluar të energjisë së erës dhe rreth 30% e kapacitetit të instaluar të energjisë diellore në Ukrainë kishte dalë jashtë funksionit që nga qershori 2022. Kjo preku gati një të katërtën e kapacitetit total të energjisë së erës në rajon, dhe një të pestën e kapacitetit të tij diellor duke qenë se Ukraina ka qenë lider në instalimet dhe investimet e rinovueshme në vitet e fundit.

“Pushtimi rus i Ukrainës dhe përhapja e pasojave të tij në vendet fqinje, po dëmton prodhimin e energjisë së rinovueshme në afat të shkurtër. Në të njëjtën kohë, ajo ka hedhur dritë të re mbi përfitimet nga një tranzicion i shpejtë i burimeve të energjisë, si dhe mund të sjellë një rritje të konsiderueshme të instalimeve të burimeve të rinovueshme në rajon”, tha Adib.

Potenciali për burimet e rinovueshme në rajon mbetet i pashfrytëzuar

Pavarësisht rritjes së ndjeshme të energjisë së rinovueshme, potenciali i burimeve të rinovueshme në sektorë të tjerë mbetet i pashfrytëzuar. Ndërtesat, transporti dhe industria kanë konsumin më të madh të energjisë në të gjithë rajonin, megjithatë pjesa e burimeve të rinovueshme në përdorimin e energjisë në këta sektorë, ka ndryshuar vetëm pak. Në 2020, Ukraina arriti pjesën më të lartë të energjisë së rinovueshme në transport në të gjithë rajonin, me vetëm 2.5%.

Politikat e efikasitetit të energjisë, veçanërisht për ndërtesat, janë përmirësuar shumë në të gjithë rajonin gjatë pesë viteve të fundit. Megjithatë, intensiteti i energjisë në të gjitha vendet në fokus, përveç Shqipërisë, mbeti më i lartë se në Bashkimin Evropian (EU-27) në 2019, me normat më të larta në Turkmenistan dhe në Federatën Ruse.

Nevoja për rritjen e investimeve, zinxhirët e furnizimit të brendshëm dhe bashkëpunimin rajonal

Raporti dokumenton përparim të rëndësishëm në miratimin e politikave dhe objektivave për energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, me të paktën 15 nga vendet në fokus që kanë vendosur objektiva kombëtare të energjisë së rinovueshme dhe 4 vende që kanë vendosur një objektiv për emetimet neto zero ose neutralitetin e karbonit. Megjithatë, mbeten boshllëqe në miratimin e politikave dhe planeve të veprimit, dhe zbatimi vazhdon të jetë i ngadaltë.

Si rezultat, investimet e kombinuara publike dhe private në burimet e rinovueshme në vendet në fokus, mbeten modeste në krahasim me prirjet e rritjes në botë. Në vitin 2016, investimet për energjinë e rinovueshme në rajon ranë në 2.7 miliardë dollarë përpara se të ktheheshin në nivelin e 2013 prej 7.2 miliardë dollarësh në 2018, duke përfaqësuar rreth 2.2% të totalit botëror. Krahasimisht, BE-ja investoi 56.5 miliardë dollarë në burime të rinovueshme në vitin 2018.

“Për të garantuar një të ardhme me karbon të ulët, e me kosto të qëndrueshme të energjisë, shtetet duhet të angazhohen sot për një sistem energjie të bazuar në burimet e rinovueshme. Kjo mund të arrihet përmes zbatimit të politikave, financimit afatgjatë për rritjen e zinxhirëve të furnizimit vendas dhe bashkëpunimit më të fortë rajonal”, tha Algayerova.

“Siguria e energjisë shkon krahas për krahas me sovranitetin e zinxhirit të furnizimit. Veprimet mbi bazën e politikave, duhet të promovojnë prodhimin vendas të energjisë së rinovueshme dhe teknologjitë efikase, si dhe të inkurajojnë zhvilluesit e projekteve që të përdorin pajisjet vendore”, shtoi Adib.

Pjesa më e madhe e vendeve në fokus, janë importuese të teknologjive kyçe si panele diellore dhe kolektorë, turbina me erë, dhe soba efikase të ngrohjes. Investimi në zinxhirët e furnizimit vendas mund të përmirësojë cilësinë e ajrit dhe shëndetin, të krijojë vlerë të shtuar dhe të nxisë rritjen ekonomike. Burimet e rinovueshme të shpërndara (të decentralizuara), të cilat mbeten kryesisht të pashfrytëzuara në rajon, mund të ndihmojnë në kapërcimin e varfërisë energjetike, si dhe në nxitjen e rritjes ekonomike. Ato mund të fuqizojnë palët e interesuara (si bashkitë, komunitetet dhe qytetarët), të rrisin barazinë gjinore dhe të forcojnë qëndrueshmërinë ndaj goditjeve të tilla si fatkeqësitë natyrore dhe konfliktet.

About REN21 and the *REN21 UNECE Renewable Energy Status Report 2022*

REN21 is the only global community of renewable energy actors from science, academia, governments, non-governmental organisations and industry across all renewable energy sectors. Our community is at the heart of our data and reporting culture. All our knowledge activities, including the *REN21 UNECE Renewable Energy Status Report 2022*, follow a unique reporting process that has allowed REN21 to be globally recognised as a neutral data and knowledge broker. All REN21 documents carrying the REN21 stamp have been produced according to a six-pillar process:

- Developing **data collection** methods that build on a global multi-stakeholder community of experts from diverse sectors, enabling access to dispersed data and information that frequently are not consolidated and are difficult to collect.
- Consolidating formal (official) and informal (unofficial/unconventional) data gathered from a wide range of sources in a collaborative and transparent way (e.g., by using extensive referencing).
- Complementing and validating data and information in an open **peer-review** process.
- Obtaining expert input on renewable energy trends in the target year through **interviews** and personal communication between the REN21 team and authors.
- Using validated data and information to provide fact-based evidence and to develop a supportive narrative to **shape the global and regional debate** on the energy transition, monitor advancements and inform decision processes.
- Making data and information **openly available** and our sources transparent so they can be used by people in their work to advocate for renewable energy.

The *REN 21 UNECE Renewable Energy Status Report 2022* benefited from the comments and feedback of more than 260 contributors and peer reviewers from the region and around the world.

About the United Nations Economic Commission for Europe (UNECE)

The United Nations Economic Commission for Europe (UNECE) was set up in 1947 by ECOSOC and is one of five regional commissions of the United Nations. UNECE's major aim is to promote pan-European economic integration. UNECE has been working on energy issues for the past 75 years, bringing together 56 countries in Europe, North America, Central Asia and Western Asia. Since 2014, UNECE holds a dedicated Group of Experts on Renewable Energy, which carries out concrete result-oriented activities that help significantly increase the uptake of renewable energy in the region. UNECE works to promote a sustainable energy development strategy for the region, with the following objectives:

- sustained access to high quality energy services for all individuals in the region;
- security of energy supplies in the short-, medium- and long-term;
- facilitate a transition to a more sustainable energy future and introduce renewable energy sources to reduce health and environmental impacts resulting from the production, transport and use of energy;
- well-balanced energy network systems across the region, tailored to optimise operating efficiencies and overall regional cooperation;

- sustained improvements in energy efficiency, in production and use, particularly in countries with economies in transition; and
- in the context of post-EU enlargement, the integration of energy restructuring, legal, regulatory and energy pricing reforms, as well as of the social dimension into energy policy making.

Media Contact

- Yasmine Abd El Aziz, **REN21** (+33 6 52 25 69 52) press@ren21.net
- Jean Rodriguez, **UNECE** (+41 79 444 50 81) jean.rodriguez@un.org
- Jose Bonito, **World Media Wire** (+44 7528 016224) jose.bonito@worldmediawire.com
- Komila Nabiyeva, **Consultant** (+49 157 535 54 799) comms.nabiyeva@web.de